

## INFORMACION

### MBI VEPRIMTARINË E GRUPIT TE Oponencës Teknike (Periudha kohore 22 Shtator-30 Shtator)

Në zbatim të V.K.M. Nr. 547, datë 09.08.2006 “Për krijimin e Agjensisë Kombëtare të Burimeve Natyrore” të ndryshuar, Urdhërit të Ministrit të MEI-it Nr.130, datë 20.03.2014 “Për ngritjen e grupit të Oponencës Teknike të projekteve të ndërtimit të hidrocentraleve me koncesion në AKBN”, Rregullores “Për funksionimin e grupit për kryerjen e Oponencës Teknike” dhe Urdhërit të Drejtorit Ekzekutiv Nr.739, datë 02.07.2014, Drejtoria Hidroenergjitike ka organizuar veprimtarinë e punës së Grupit të Oponencës Teknike, për mbledhjen e **datës 25 Shtator 2014**, do të shqyrtojë projektet e zbatimit si më poshtë:

1. Shqyrtimi dhe vlerësimi i projektit të zbatimit për ndërtimin e hidrocentralit “**Prishta 1 dhe 2**” të shoqërisë koncesionare “HP Prishta 1 dhe 2 Energy” sh.p.k. në zbatim të shkresës së MEI-it me Nr. 34/16 Prot. datë 13.05.2014 Ky projekt zbatimi është hartuar nga Studio e Projektimit “Engineering Systems” sh.p.k.
2. Shqyrtimi dhe vlerësimi i Studimit i fizibilitetit për HEC-in “Molla” të shoqërisë investitore për në zbatim të shkresës së MEI-it me Nr. 6100/1 Prot. datë 17.09.2012
3. Rishqyrtime të projekteve të zbatimit në proces sipas datave hyrëse në protokollin e AKBN të shkresave me dokumentacionin plotësues sipas raporteve të vërejtjeve të OT.

**DREJTORIA HIDROENERGJITIKE**  
**Spektori i Oponencës Teknike**